

*Intervista/Kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri Pavel Vacek jep zgjidhjen për publikimet e emrave*

## **Listat e reja, me ndihmën e KQZ**

***Vacek: Ministria e Pushtit Vendor të ndërtojë qendrën***

*Blerina Gjoka*

*Përfaqësuesi i OSBE-së në Tiranë, ambasadori Pavel Vacek e sheh çështjen e heqjes së dublimeve në listat e zgjedhësve si një problem që u takon shumë institucioneve. Në një intervistë ekskluzive për Gazetën Shqiptare, Vacek sqaron rrugën në të cilën duhet të ecë ky proces, i cili, sipas tij, kërkon mbështetjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (MPVD) dhe, në mënyrë të veçantë, të bashkive dhe komunave. Detyra përfundimtare për heqjen e dublikimeve dhe përgjegjësia bie mbi kryetarët e bashkive dhe komunave. Vetëm ata mund t'i ndryshojnë listat e zgjedhësve dhe të shtojnë ose të heqin njerëz prej tyre, thekson Vacek. Gjatë diskutimit të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ofroi ndihmën e saj në lidhje me regjistrin e votuesve. Pranë KQZ-së është bërë një investim prej gati 4 milionë USD. Por Partia Demokratike e kundërshtoi mundësinë e pjesëmarrjes së KQZ-së në këtë proces dhe kjo u përkrah edhe nga OSBE-ja. Tani, Vacek nënvizon rëndësinë që ka KQZ-ja në këtë proces. Ndërsa afati i zgjedhjeve afron, listat e zgjedhësve vazhdojnë të mbeten peng për shkak të një boshllëku ligjor.*

### **1. Cili është afati për eliminimin e dublikimeve në listat e zgjedhësve?**

Me sa jam në dijeni, brenda datës 15 mars 2005, të gjithë kryetarët e njësive të qeverisjes vendore ku qytetarët janë regjistruar në regjistra të përkohshëm, do të duhej të njoftojnë kryetarët e njësive të qeverisjes vendore ku këta qytetarë kanë vendbanimin e tyre të përhershëm për ekzistencën e vendbanimit të përkohshëm. Në këtë mënyrë, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore ku qytetarët kanë vendbanimin e përhershëm do të mund të shmangin dublimin e të dhënave në listat e zgjedhësve. Nga 1 prilli, deri 25 ditë para ditës së zgjedhjeve, kohë kur miratohet Lista Përfundimtare e Zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) në Ministrinë e Pushtetit Vendor e Decentralizimit (MPVD) pritet të informojë kryetarët e bashkive/komunave për dublikimet e mundshme në listat e zgjedhësve të përgatitura nga kryetarët e bashkive/komunave. DPGJC-ja do të duhej t'i identifikojë këto dublikime pas verifikimit në nivel kombëtar të të gjitha listave që i janë dorëzuar DPGJC-së në format elektronik nga të gjithë kryetarët e bashkive/komunave. Për të qenë në gjendje të kontrollojë për dublikime të mundshme, DPGJC-ja do të duhej t'i përpunojë të gjitha listat individuale të ardhura nga kryetarët e bashkive/komunave në një bazë të dhënash në nivel kombëtar. Flasin për nevojën e të pasurit të një strukture të tillë qendrore për përpunimin e të dhënave brenda Ministrisë, sepse është e qartë që është fizikisht e pamundur që një kontroll i tillë të bëhet në mënyrë korrekte në nivel individual kryetarësh bashkie/komune – secili prej tyre do të duhej të komunikonte njëkohësisht me qindra kryetarë të tjerë bashkish/komunash (të cilët nuk janë të lidhur nëpërmjet asnjë rrjeti komunikimi të qëndrueshëm e të besueshëm) dhe rezultati mund të ishte një rrëmujë e vërtetë. Dublikimet që

mund të ndodhin në lista mund të jenë të llojeve të ndryshme. Në shumicën e rasteve, sa herë që një qytetar është regjistruar në më shumë se në një vend në të njëjtën kohë, ka mënyra për ta zgjidhur këtë.

## **2. Nëse pastrimi i dublikimeve në listat e zgjedhësve nuk do të bëhet në kohë, ç'kosto do të kishte kjo për zgjedhjet?**

Regjistrimi i dyfishtë është jo vetëm i padëshirueshëm në vetvete, por, gjithashtu, përbën një shkelje serioze të Kodit Zgjedhor. Sigurisht, ka masa mbrojtëse të tjera të mundshme për të shmangur votimin e shumëfishtë të zgjedhësve, si p.sh., shenjimi me bojë të veçantë i zgjedhësve që kanë votuar (në gishtin e madh të dorës). Masa të tilla nuk përbëjnë një ilaç për të gjitha të këqijat, gjithsesi, ato shtojnë koston e të gjithë procesit dhe kërkojnë një zbatim të qëndrueshëm nga të gjitha komisionet e qendrave të votimit në mënyrë që të jenë efikase.

## **3. Kodi Zgjedhor nuk parashikon se cili institucion duhet të merret me pastrimin e dublikimeve? Si do të zgjidhet kjo?**

Në lidhje me këtë çështje, Kodi nuk është aq shterues sa sa do të duhej të ishte idealisht, megjithatë nuk ka vakuum të plotë ligjor. Ne besojmë se tri institucionet më të lidhura me këtë çështje, pra Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe kryetarët e bashkive/komunave do të duhej të bashkëpunojnë në mënyrë aktive të udhëhequr nga qëllimi i përbashkët. KQZ-ja do të duhej t'ia ofrojë ekspertizën dhe të dhënat e saj Ministrisë; Ministria do të duhej të ngrejë një strukturë qendrore për përpunimin e të dhënave, të njoftojë kryetarët e bashkive/komunave për dublikimet dhe gabimet e mundshme; dhe kryetarët e bashkive/komunave do të duhej të kërkojnë aktivisht këshillim dhe mbështetje nga Ministria në kryerjen e punës së tyre parësore, pra hartimit të listave të zgjedhësve, që përbëjnë përgjegjësinë e tyre përfundimtare.